



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 109/2018

Datë: 23 shkurt 2018

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës së datës 23 shkurt 2018-KPK/Nr.108/2018, shpall:

SHPALLJE E BRENDSHME

Për avancim të prokurorëve të shtetit

I. Tetë (8) pozita për prokurorë, si në vijim:

- Tri (3) pozita në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;
- Një (1) pozitë në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore Prishtinë;
- Tri (3) pozita në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore Mitrovicë, dhe
- Dy (2) pozita në Prokurorinë Themelore Ferizaj, një (1) pozitë në Departamentin për Krime të Rënda dhe një (1) pozitë në Departamentin për të Mitur.

II. Kandidatët e interesuar për avancim duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Për të ushtruar funksionin e prokurorit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, prokurori duhet të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë si prokuror si dhe bazuar në vlerësimin e performancës;
2. Për të ushtruar funksionin e prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda apo për të Mitur në Prokurorinë Themelore, prokurori duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë si prokuror apo gjyqtar në lëmin penal si dhe bazuar në vlerësimin e performancës;
3. Të kenë mandat të përhershëm;

4. Të kenë vlerësim pozitiv të performancës;
5. Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore, përveç qortimit.
6. Pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhet me procedurën penale, mjetet juridike, praktikat juridike të gjykatave vendore dhe ndërkombëtare do të merret parasysh.

III. Kandidati që parashtron kërkesë për avancim duhet të dorëzojë edhe dokumentet si në vijim:

1. Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
2. Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
3. Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivisht të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë për avancim.

V. Afati për dorëzimin e kërkesës për avancim është nga data 01 mars 2018 deri me datë 15 mars 2018.

VI. Kërkesa për avancim duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e parë (1) të ish ndërtesës së EULEX-it, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 18, të mbyllura në zarf, ose me postë.